

JOHANNES KODER

**DEFTER-I SANCAK-I ARVANID SI BURIM TË DHËNASH
DEMOGRAFIKE MBI EPIRIN NË KAPËRCYELLIN
PREJ SUNDIMIT BIZANTIN NË ATË OSMAN
ME DY HARTA DHE GJASHTË TABELA ***

Me ftesën miqësore të Evangelos Chrysos, atëherë profesor në Universitetin e Janinës, pata nderin gati tridhjetë vjet më parë që të mbaj atje një ligjëratë për çështje që lidhen me ngulimet sllave dhe toponiminë mesjetare të Epirit, e cila u botua pak më vonë. Burimi kryesor i shkruar i përsiatjeve të mia të atëhershme ishte *Defter-i Sancak-i Arvanid*¹ i vitit 1431/1432, që ishte hartuar menjëherë pasi Janina iu dorëzua rrethuesve turq dhe që, siç duket, mbështetet kryesisht në një regjistër taksash të arkivit të atjeshëm të administratës së periudhës së vonë bizantine, i cili u shërbeu pushtetarëve të rinj si bazë për ndarjen e tokave dhe caktimin e taksave. Artikulli im i atëhershëm shqyrtonte në radhë të parë fuqinë shprehëse të toponimeve për historinë e hershme mesjetare të popullsisë dhe ngulimeve në atë pjesë të sanxhakut, që përkonte me trevën e periudhës antike të vonë dhe bizantine të hershme të *Παλαιά Ἠπειρος* (*Epirus vetus*)². Në lidhje me artikullin e atëhershëm dhe hulumtime të

* Ky artikull botohet për herë të parë në gjuhën shqipe. Botimet e dala pas hartimit të këtij shkrimi nuk janë marrë parasysh: M. Delilbaşi, “A Contribution to the History of Epirus (XVth-XVIth Centuries) – Special Reference to the Privileges Granted to the People of Epirus by Sultan Murad II”, *GAMER* 1.1 (Ankara 2012) f. 37-60.

The Cambridge history of Turkey, II. The Ottoman Empire as a World Power, 1453 – 1603, botuar nga S. N. Faroqi, Cambridge 2013.

¹ H. İnalçık (botues), *Hicri 835 Tarihi Sûret-i defter-i Sancak-i Arvanid*, Ankara: 1954.

² Për këtë, në secilin rast me literaturë të mëtejshme: P. Soustal, *Tabula Imperii Byzantini 3: Nikopolis und Kephallenia* [Denkschriften der philosophisch-historischen Klasse der Österreichischen Akademie der Wissenschaften, 150], në bashkëpunim me J. Koder, Vjenë: 1981; mbi administrimin e provincave të veçanta në shek. XIII: G. Prinzing, *Studien zur Provinz – und Zentralverwaltung im Machtbereich der epirotischen Herrscher Michael I und Theodoros Dukas* (Studime mbi administrimin provincial dhe qendror në zotërimet e sundimtarëve epirotë Mihal I dhe Teodor Duka), Teil II (Pjesa II), *Ἠπειρωτικά Χρονικά* 25 (1983) f. 37–109.

tjera mbi demografinë e hapësirës bizantine³, po ndërmerret këtu përpjekja për t'i vlerësuar informacionet për numrin, përhapjen dhe dendësinë e popullsisë e të ngulimeve në të gjithë hapësirën e Sanxhakut Arnaut Osman.^{*}

Sancak-i Arvanid ose *Arnavud-ili* u krijua prej vitit 1394 në zonën e "Despotatit" të dikurshëm bizantin të Epirit dhe përfshinte prej viteve 1415/18 Shqipërinë e Mesme dhe të Jugut; kryeqytet i rajonit ishte Aryurikasrı (Gjirokastrë / Argyrokastron). Ndërmjet viteve 1443 dhe 1459 ushtrimi i pushtetit nga ana e Perandorisë Osmane mbi sanxhak u ndikua prej veprimeve ushtarake, sidomos kryengritjes së Skënderbeut, dhe ishte në disa zona përkohësisht i pamundur.⁴ Pra, rajoni që po trajtojmë këtu iu nënshtrua gjatë shek. XV shumë ndryshimeve të dhunshme nga pikëpamja e strukturës sunduese, të cilat patën ndikim në gjendjen ekonomike dhe numrin e strukturën e popullsisë.

³ Krh. bibliografinë te: J. Koder, *To Βυζάντιο ως χώρας. Εισαγωγή στην ιστορική γεωγραφία της Ανατολικής Μεσογείου στη Βυζαντινή εποχή*, Selanik: 2004, f. 294–312; Tjetër literaturë e përzgjedhur: E. Chrysos, "Settlements of Slavs and Byzantine Sovereignty in the Balkans", në: K. Belke – E. Kislinger – A. Külzer – M. Stassinopoulou (botues), *Byzantina Mediterranea, Festschrift für Johannes Koder zum 65. Geburtstag (Botim jubilar me rastin e 65-vjetorit të Johannes Koder)*, Vjenë – Këln – Vajmar: 2007, f. 123–135; Z. Djoković, "Stanovništvo istočne Makedonije u prvoj polovini XIV veka (La population de la Macédoine de l'Est dans la première moitié du XIVe siècle)", *ZRVI* 40 (2003) f. 97–244; K. Mustakas, "Η δημογραφική κρίση του ύστερου Μεσαίωνα στον ελληνικό χώρο. Η περίπτωση της Νοτιο-Ανατολικής Μακεδονίας (14ος–15ος αι.)", *Μνήμων* 25 (2003) f. 9–33; D. Stathakopoulos, "Population, demography, and disease", në: R. Cormack – J. Haldon – E. Jeffreys (eds.), *The Oxford Handbook of Byzantine Studies*, Oksford: 2008, f. 309–316, secili me literaturë të mëtejshme.

^{*} Në origjinalin gjermanisht: des osmanischen *Sancak-i Arvanid*. Më poshtë është përkthyer si Sanxhaku Arnaut. Sûret-i Defter-i Sancak-i Arvanid është libri i parë i Perandorisë Osmane i shkruar në osmanishten e vjetër në të cilën shqiptarët quheshin arvanid prej greq. arvanitas dhe jo arnavut (shën. i përkthyeses).

⁴ Krh. në përgjithësi K.-P. Matschke, "Der Übergang vom byzantinischen Jahrtausend zur Turkokratie und die Entwicklung der südosteuropäischen Region (Kalimi nga mijëvjeçari bizantin në turkokrati dhe zhvillimi i rajonit të Evropës Juglindore)", *Jahrbücher für Geschichte und Kultur Südosteuropas* 1 (1999) 11–38; A. Birken, *Die Provinzen des Osmanischen Reiches* (Provincat e Perandorisë Osmane), Wiesbaden 1976, f. 52; *EF*², v. 9, s.v. Sandjak (Encyclopaedia of Islam, 2nd edition, volume 9, sub voce Sandjak - shën. i përkthyeses) (J. Deny – M. Kunt), 12–14; për Shqipërinë O. J. Schmitt, *Das venezianische Albanien (Shqipëria veneciane) (1392–1479)* [Südosteuropäische Arbeiten 110], München: 2001.

Prandaj Defteri i Sanxhakut Arnaut përfaqëson në disa pikëpamje vetëm një moment, sepse ai u krijua më 1431/32, pra mjaft kohë para vdekjes së Skënderbeut (1468) dhe para stabilizimit të sundimit turk. Defteri mund të shërbejë si bazë e një përpjekjeje për rindërtimin e një historie të pejzazhit të ngulimeve për shkak të një numri të madh toponimesh, që përmenden aty dhe që në një pjesë tepër të madhe ishin të identifikueshme ose të paktën të lokalizueshme si vende të shkretuara deri në gjysmën e dytë të shek. XX; këtë e tregon një krahasim me hartat moderne dhe sidomos me fletët përkatëse të Hartës së përgjithshme të Evropës Qendrore të hartuar në fund të shek. XIX.⁵ Që shumë toponime u referohen pushtimeve sllave në fund të shek. VI dhe në fillim të shek. VII është sqaruar që më parë⁶ dhe po përmendet lidhur me problematikën që po diskutojmë këtu vetëm për shkak se ky fakt ka rëndësi përse i përket stabilitetit të strukturës ngulimore që rrjedh (rezulton) prej tij.

Defteri shqyrton një zonë⁷ me sipërfaqe rreth 10.700 km² midis lumit Ishëm në veri dhe rrjedhës së poshtme të Kallamas afër Igumenicës në jug; kufiri lindor i zonës në fjalë ecte afërsisht gjatë vijës ndarëse malore të atyre lumenjve që derdhen në detin Adriatik (Harta 1⁸). Kjo zonë u përgjigjet pjesëve perëndimore dhe qendrore të Shqipërisë së Mesme dhe Jugore dhe pjesë fare të vogla i takojnë Epirit në Greqinë Veriperëndimore. Pa llogaritur ultësirat aluvionore, që shtrihen përgjatë brigjeve prej veriut deri në Vlorë në një gjerësi mbi 50 km perëndim-lindje, arrijmë në përfundimin që në rastin e Sanxhakut Arnaut bëhet fjalë për një malësi pjesërisht të pakalueshme, me prodhim të paktë bujqësor (drejtimi kryesor i shtrirjes së vargmaleve prej veri-veriperëndimit drejt

⁵ *Karte von Albanien (Hartë e Shqipërisë) 1:200.000*, fleta veriore dhe jugore, botuar nga Sektori i topografisë kryesore XIV, Vjenë: 1939; shih edhe *Generalkarte Mitteleuropa* (Harta e përgjithshme e Evropës Qendrore) 1:200.000, Fl. 38° 40° Korfu (Korfuzi), behelfsmäßige Ausgabe (botim provizor), po aty, 1940.

⁶ Koder, Προβλήματα.

⁷ Për strukturën gjeografike të zonës shih P. Jordan (botues), *Albanien: Geographie / historische Anthropologie / Geschichte / Kultur / postkommunistische Transformation* (Shqipëria: gjeografi / antropologji historike / histori / kulturë / transformim postkomunist), Vjenë dhe të tjera 2003; C. Lienau – G. Prinzing (botues), *Beiträge zur Geographie und Geschichte Albaniens* [Berichte aus dem Arbeitsgebiet Entwicklungsforschung 12] (Shkrime për gjeografinë dhe historinë e Shqipërisë [Raporte nga lëmi Hulumtim i zhvillimit 12]), Münster: 1986.

⁸ Harta 1: *Shqipëria 1:1.000.000*, K. u. k. Militärgeographisches Institut (Instituti Perandorak dhe Mbretëror i Gjeografisë Ushtarake), Vjenë: pa vit.

jug-juglindjes^{*}), duke pasur parasysh që masivet malore ngrihen deri mbi 2500 m. Në jug të Vlorës fillon Malësia bregdetare Keraunike (me maja deri pak mbi 2000 m); zbret menjëherë rrëpirë në detin Jon, ndërsa bregu gati 100 km midis Orikumit dhe Sarandës është jashtëzakonisht i vështirë për t'u banuar.

Lumenjtë më të rëndësishëm janë (prej jugut në veri) Pavle, më tej lumenjtë që ushqejnë lagunën e Butrintit, Vjosa me degët e saj ushqyese (afluentët) Shushica dhe Drino, Semani me degët e tij ushqyese Osum dhe Devoll, Shkumbini, Erzeni dhe Ishmi (Mati gjendet jashtë Sanxhakut Arnaut). Luginat e lumenjve të përmendur e kanë origjinën e tyre, në përputhje me shtrirjen e maleve, kryesisht në juglindje dhe hapen nga veriperëndimi, përkatësisht perëndimi drejt ultësirës bregdetare. Ato përcaktojnë në këtë mënyrë në masë të madhe edhe shtrirjen e rrjetit rrugor mbirajonal.

Të dhënat e Defterit ndjekin në klasifikimin e tyre një renditje të përafërt prej jugut në veri. Në botimin e Halil İnalçık jepet një ndarje në dhjetë vilajete, përkatësisht nahijete⁹ me një sipërfaqe tejet të ndryshme. Në mënyrë të përmbledhur ndarjet një nga një mund të pasqyrohen si më poshtë (Harta 2¹⁰):

- [I.] Zona e kryeqytetit të Sanxhakut, pra e vilajetit Aryurikasrı (Argyrokastron); përfshinte nahijetin Lahtakasru (Lachanokastro), vilajetin Vayonetya (Bagenetia), nahijetin Himara (Cheimara), një pjesë të vogël të nahijetit Belgrad (Belgradi, Berat) dhe nahijetin Muzakiye¹¹; me rreth 3285 km². Vilajeti Aryurikasrı ishte jashtëzakonisht më i madh se distriktet e tjera, sipërfaqja e të cilave lëkundej midis 160 km² dhe 1370 km²;
- [II.] nahijeti Sopot (Sopotos¹²) me 8 timare¹³, afërsisht 160 km²;
- [III.] vilajeti Klisura (Kelcyrë) me 8 timare¹⁴, afërsisht 270 km²;

* Veri-veriperëndim është drejtimi midis veriut dhe veriperëndimit, po ashtu jug-juglindje është drejtimi midis jugut dhe juglindjes (shën. i përkthyeses).

⁹ Në origjinalin gjermanisht *Vilâyets* dhe *Nâhiyets*.

¹⁰ Harta 2: *Die Vilâyets des Sancak-i Arvanid* (Vilajetet e Sanxhakut Arnaut).

¹¹ Zona e sundimit të familjes shqiptare Muzaka, krh. İnalçık, *Sancak-i Arvanid*, f. 1–27, Timare 1–58.

¹² Në fakt edhe sot Sopot, Sopot (shën. i përkthyeses).

¹³ İnalçık, *Sancak-i Arvanid*, f. 27–30, Timare 59–66.

¹⁴ İnalçık, *Sancak-i Arvanid*, f. 30–33, Timare 67–74.

- [IV.] vilajeti Kanina (Kanina afër Vlorës) me 70 timare¹⁵, afërsisht 1270 km²;
 [V.] vilajeti Belgrad (Berat) me 61 timare¹⁶, afërsisht 1295 km²;
 [VI.] vilajeti Tomorince (Tomorri*) me 10 timare¹⁷, afërsisht 260 km²;
 [VII.] vilajeti Iskarapar me 25 timare¹⁸, afërsisht 585 km²;
 [VIII.] vilajeti Pavlo Kurtik me 21 timare¹⁹, afërsisht 1100 km²;
 [IX.] vilajeti Çartalos me 15 timare²⁰, afërsisht 1105 km²;
 [X.] vilajeti Akçahisar (Kroia, Krujë) me 60 timare²¹, afërsisht 1370 km².

Kufijtë e brendshëm të dhjetë rajoneve të pjesshme brenda Sanxhakut janë të paracaktuar nëpërmjet sipërfaqes së tyre të jashtme: ata ndjekin përgjithësisht kreshtat e vështira për qarkullim të maleve. Përrjashtim bëjnë ultësirat bregdetare midis Lezhës dhe Vlorës. Pesë njësitë administrative që shtrihen në jug dhe jugperëndim, si dhe ajo më në veri (e dhjeta) emërtoheshin sipas kryeqendrave të tyre, katër të tjerat sipas emrave të krahinave ose familjeve. Emrat e pesë provincave të para dhe gati të gjitha emrat e nëndarjeve të provincës së parë²² janë marrë me shumë probabilitet nga kadastra bizantine; në bazë të tyre qëndron – siç ndodh me shumë emra provincash bizantine të Mesjetës së Vonë - emrat e kryeqendrave.**

Më vonë, Perandoria Osmane u nda gjerësisht në mënyrë uniforme në njësitë administrative të *sanxhaqeve* (provincave), që përmbledheshin në *ejalet* (pak a shumë "rajone"), sanxhaqet ndaheshin më tej në vilajete (pak a shumë "rrethe"), përkatësisht *kaza* dhe në *nahijete* (distrikte), dhe më së fundi në njësitë më të vogla *kurâ* (shumës i *karye*, prej greq.

¹⁵ İnalçık, *Sancak-i Arvanid*, f. 33–55, Timare 75–144.

¹⁶ İnalçık, *Sancak-i Arvanid*, f. 55–74, Timare 145–205.

* Në fakt edhe në ditët tona Tomorricë (shën. i përkthyeses).

¹⁷ İnalçık, *Sancak-i Arvanid*, f. 75–77, Timare 206–215.

¹⁸ İnalçık, *Sancak-i Arvanid*, f. 78–85, Timare 216–239.

¹⁹ İnalçık, *Sancak-i Arvanid*, f. 85–97, Timare 240–260.

²⁰ İnalçık, *Sancak-i Arvanid*, f. 97–102, Timare 261–275.

²¹ İnalçık, *Sancak-i Arvanid*, f. 102–120, Timare 276–335.

²² Me përjashtim të nahijetit Muzakiye, shih shënimin 10 dhe 11.

** Kruja mban tashmë emrin turk Akçahisar, emri Tomorince vjen nga Malësia e Tomorrit, krahina Iskarapar është e njëjta me emrin e distriktit të sotëm Skrapar në provincën e Beratit, Pavlo Kurtik është emri i një timarioti shqiptar, Çartalos duhet ta ketë prejardhjen nga emri i një familjeje.

chorion "fshat"), përkatësisht *mahalle* ("lagje qyteti"). Kjo ndarje nuk pasqyrohet ende në Defter. Ndërsa atje përcaktohet fshati (*karye/chorion*) si njësi më e vogël, nuk shquhet ende një dallim i njësisishëm midis *vilajetit* dhe *nahijetit*.

Si elemente të reja klasifikimi pa lidhje me strukturën ekzistuese historike të krahinës së banuar epirote shfaqen në Defter 335 *timare*, në të cilat janë bashkuar shpesh disa fshatra ose pjesë fshatrash. Më tej përmenden disa *mevkufât* (fondacione fetare sipas së drejtës islame), por numri i tyre është ende shumë i vogël për arsye të njohura, saqë rëndësia e tyre ekonomike dhe demografike në kontekstin e fillimit të shek. XV, mund të mos merret parasysh.

Defteri i viteve 1431/32 (tabela 1) i shënon emrat e vendeve të ndarë sipas dhjetë rajoneve të përmendura. Brendapërbrenda rajoneve nuk vërehet një klasifikim i vazhdueshëm dhe konsekuent, edhe pse vende fqinje shpesh numërohen së bashku dhe pasohen në çdo rast nga timariotët. Rregullisht Defteri jep përveç kësaj edhe numrin e shtëpive taksapaguese të plota (*hane*), më pak të sakta janë shtëpitë e të veve (*bîve*) dhe të të pamartuarve (*mücerred*). Së fundi, ai jep për disa vende ose rajone taksat që duhet të paguajnë çdo vit në të holla (*akçe*²³), por këto shpesh jo të plota ose dukshëm të pasakta. Mangësitë shpjegohen, të paktën pjesërisht, me faktin që midis dorëzimit* të Janinës në tetor 1430 dhe përpilimit të Defterit kishte kaluar pak më shumë se një vit, prandaj nëpunësit që ishin ngarkuar me përcaktimin dhe verifikimin e numrit të taksapaguesve ishin të mbingarkuar për arsye të ndryshme praktike. Për pasojë nuk mund të bëhej një inventarizim i plotë i atyre që ishin të detyruar të paguanin taksa; sqarimet përkatëse për mungesën ose karakterin provizor të disa të dhënave gjenden në tekst.²⁴

Defteri përfshin gati 1.285 vendbanime në një sipërfaqe prej rreth 10.700 km², shumica fshatra të vogla. Pjesërisht ata përmenden disa herë,

²³ *akçe* ("e vogël e bardhë <monedhë>"), greq. *aspron*, në burimet perëndimore *asper*, monedha standard (d 18 mm), e cila deri më 1444 (Murad II., †1451) peshonte 1,1g dhe përbëhej deri në 90% prej argjendit, shih *ET*², *Akçe* (H. Bowen), f. 327.

* Me kuptimin e kalimit të pushtuesit turq dhe jo të kapitullimit (shën. i përkthyeses).

²⁴ P.sh. kur në Defter shënohet që asnjëri prej kryepleqve nuk kishte ardhur në një takim zyrtar, megjithëse ishin thirrur; për këtë Sp. Shkurti, *Der Mythos vom Wandervolk der Albaner. Landwirtschaft in den albanischen Gebieten, 13. – 17. Jahrhundert* (Miti i shqiptarëve si popull nomad. Bujqësia në territoret shqiptare, shek. XIII – XVII) [Zur Kunde Südosteuropas, Albanologische Studien 1], Vjenë [dhe të tjera]: 1997, f. 42.

zakonisht atëherë kur në një fshat ka më shumë se një timariot që ka pjesë.²⁵ Në përgjithësi, mund të supozohet se një fshat ka mesatarisht një sipërfaqe prej rreth 10 km² tokë me kualitet të ndryshëm.

Numri i shtëpive të regjistruara (= njërive taksapaguese) është 22.851²⁶, duke pasur parasysh që për qëllimin e këtij hulumtimi mund të injorohet dallimi midis shtëpive të plota, të të veve dhe të të pamartuarve, meqë shifrat e dhëna për dy të fundit me sa duket shpesh nuk mund të gjendeshin prej nëpunësve të taksave dhe prandaj nuk regjistroheshin; kështu ata përbëjnë vetëm 6,21 %²⁷. Mesatarisht për çdo vendbanim llogariteshin 17,8 ekonomi familjare (shtëpi) që ishin të detyruara të paguanin taksa.

Por, duhet theksuar që numri i përgjithshëm i ekonomive familjare në zonën e Arnautit duhej të ketë qenë në çdo rast më i lartë se ai që shënohet në Defter. Kjo nuk mund të shpjegohet vetëm me karakterin e sapopërmendur provizor të dokumentit të hartuar brenda një kohe të shkurtër, por edhe me faktin që pjesë të bregut që e kufizonin Sanxhakun Arnaut nga perëndimi nuk i takonin ende Perandorisë Osmane. Këto ishin qytete bregdetare të populluara me një hinterland pjellor: Dyrrachion (Durrës, Durazzo) ishte deri në vitin 1501 nën sundimin venecian, H. Saranta (Sarantë, Santi Quaranta) deri 1492/3, Buthrotos (Butrinti, Butrint) deri 1800.²⁸

Kësaj i shtohen faktorë të përgjithshëm pasigurie, që kanë të bëjnë me shumë defterë të hershëm, konkretisht që ushtarët, si dhe pronarët e timareve e çifligjeve të tjerë nuk ishin regjistruar plotësisht ose aspak. E njëjta gjë vlen përgjithësisht edhe për pyetjen nëse myslimanët ishin regjistruar në Defter po aq plotësisht sa të krishterët dhe në cilën masë jetonin në zonën në fjalë familje, të cilat nuk mund të regjistroheshin fare ose plotësisht, për shkak se nuk kishin tokë, para së gjithash barinj shtegtarë, pra rritës bagëtish gjysmënomadë, shpesh vllahë, që në bazë të së drejtës zakonore mund t'i linin kopetë e tyre të kullojnë përkohësisht

²⁵ Nga kjo shpjegohet numri i përgjithshëm prej 1.048 fshatrash që ka llogaritur Shkurti, *Der Mythos*, f. 38 dhe 41.

²⁶ Shkurti, *Der Mythos*, jep në f. 38 një numër të përgjithshëm prej 21.880 shtëpish, në f. 41 jep disa shifra për numrin e shtëpive, prej të cilave del shuma 20.599.

²⁷ Shtëpi të plota 21.433 = 93,8, shtëpi të të veve 979 = 4,29 %, shtëpi të të pamartuarve 439 = 1,92 %.

²⁸ Shih Schmitt, *Das venezianische Albanien* (Shqipëria veneciane), f. 215–314 dhe 593–628.

në territore të caktuara. Sidoqoftë, në Defterin Arnaut nuk ka të dhëna për ta.

Në këto kushte edhe përsiatjet rreth numrit të popullsisë mbi bazën e ekonomive familjare të përfshira në Defter u nënshtrohen pasigurive të përmendura. Si një tjetër faktor pasigurie shtohet edhe numri i personave, të cilët bëjnë pjesë në një ekonomi familjare. Në vend të një vlere mesatare fikse, unë kam marrë për përllogaritjet e mia një kufi minimal prej 3, 5 dhe një kufi maksimal prej 6 personash për çdo ekonomi familjare (tabela 2), ndërkohë që një vlerë midis 5 dhe 6 duket se dëshmohet shpesh. Ky supozim mbështetet në botimet e kohëve të fundit për demografinë e Mesjetës së Vonë dhe të Kohës së Re të hershme në Gadishullin e Ballkanit, të cilat nisen nga argumentime të ndryshme të pakundërshtueshme të vlerave brenda kësaj hapësire.²⁹ Edhe një burim i Kohës së re, të cilin e kam konsultuar si shembull, i cili informon për katër vendbanime në një krahinë të vogël të përafërt nga gjeografia fizike në Maqedoni, ofron me 5,3-6,5 persona për ekonomi familjare disa vlera hapësinore vetëm pak më të larta.

Duke pasur parasysh këto premisa, për Sanxhakun Arnaut rezulton një vlerë midis 79.978 dhe 137.106 banorë taksapagues, që i përgjigjet një dendësi popullore prej 7,4–12,8 banorë / km² në sipërfaqen prej

²⁹ Krh. A. Laiou-Thomadakis, *Peasant Society in the Late Byzantine Empire, a Social and Demographic Study*, Princeton: 1977, f. 223–266, sidomos f. 224–227 (midis 3,67 dhe 4,7); J. C. Russell, *Medieval Demography*, New York, NY: 1987, f. 131 (3,5–5 persona/ekonomi familjare) dhe F. Zarinebaf – J. Bennet – J. L. Davis, *A historical and economic geography of Ottoman Greece. The southwestern Morea in the 18th century* [Hesperia, Suppl. 34], Athinë: 2005, f. 158 (4–4,75 persona/ekonomi familjare); më tej Koder, Προβλήματα, f. 28–30 (3,5–5 persona/ekonomi familjare); i njëjti, Überlegungen zur Bevölkerungsdichte des byzantinischen Raumes in Spätmittelalter und Frühneuzeit (Përsiatje rreth dendësisë së popullsisë në hapësirën bizantine të Mesjetës së Vonë dhe Kohës së Re të hershme), *Byz. Forschungen* 12 (1987) f. 289–305 (3,5–5); D. Georgiev, Siedlungsverhältnisse im makedonisch-albanischen Grenzgebiet im 15. und 16. Jahrhundert (nach osmanischen Quellen), [Raportet midis vendbanimeve në zonën kufitare maqedo-shqiptare në shek. XV dhe XVI (sipas burimeve osmane)], *Südostforschungen* 65/66 (2006/2007) f. 117–136, niset pa ndonjë argumentim special nga një faktor 5, N. Todorov, Quelques aspects de la ville balkanique aux XVe et XVIe siècles. Nombre et population, në: *Actes du Ier congrès international des études du sud-est européen*, II, Athinë 1972, f. 209–219, për këtë f. 211, prej 5 deri 6,25 persona/ekonomi familjare; Shkurti, *Der Mythos*, f. 51. dallon për shek. XV/XVI midis njësisive taksapaguese (familjeve) prej 3-5 persona dhe ekonomive familjare prej 8-10.

afërsisht 10.700 km² të sanxhakut. Për shkak të argumenteve që u parashtruan tashmë më lart (fq. 5-6), por edhe sepse janë regjistruar vetëm ekonomitë familjare të rëndësishme për mbledhjen e taksave, duhet të supozojmë që vlera më e lartë i afrohet më shumë realitetit.

Si pasojë e luftimeve të ngjeshura duke filluar prej fundit të shek. XIV është i saktë supozimi se numri i popullsisë në shek. XV kishte rënë në mënyrë të ndjeshme (bile rreth vitit 1430 nuk ishte arritur ende pika më e ulët). Në këtë kontekst duhet patur parasysh që burimet e shkruara të periudhës së vonë bizantine përmendin trembëdhjetë emra vendbanimesh dhe krahinash në një kuadër ngjarjesh historike, që të bënë të mendosh për një karakter vendbanimi të ngjashëm me një qytet ose treg.³⁰ Meqenëse këto toponime përkujtojnë vetëm pjesërisht me të dhënat e Defterit, arrijmë në përfundimin që në shek. XV, denduria e vendbanimeve në vendet qendrore (dhe bashkë me këtë e gjithë denduria) ishte më e ulët se më përpara, në periudhën e vonë bizantine, dhe pastaj më vonë në periudhën osmane, sepse prej shek. XVI disa qendrave iu atribuohet në mënyrë të qartë (përsëri) një karakter qytetar.³¹

³⁰ Burimet e mëposhtme dëshmojnë për këtë (duke i radhitur prej veriut në jug):

Kroa(i): Manuel Philes 3.237.289, Ephraim, Hist. 8734, *Kruai*: Georg. Sphr. 43.3.5.

Dyrrachion: Georg. Pach., Syngr. Hist. 151, 641–3, Manuel Philes 3.237.289.

Bellegrada: Manuel Philes 3.237.205 et 218, Georg. Pach., Syngr. Hist. 151, 641–3, Georg. Pach., Hist. brevis 6.32, *Balagrita*: Joh. Kant., Hist. 1.495.

Aulona: Chron. byz. brev. 60.20.1.

Kan(n)ina: Laon. Chalk. 2.29, Chron. byz. brev. 60.20.1, Georg. Pach., Syngr. Hist. 151, 641–3, Joh. Kant., Hist. 1.495, Manuel Philes 3.237.289.

Kleisura: Joh. Kant., Hist. 1.495, Chron. byz. brev. 53.16.2, 54.12.1.

Cheimarra: Joh. Kant., Hist. 509, *Chimara*: Joh. Apokaukos, Not. Epist. 57.54ff., 74.1, PRK I 2.43,49, PRK III 252.4,6.

Sopotos: Joh. Kant., Hist. 509.

Argyrokastron: Chron. byz. brev. 60.2.12 u.ö. (u.ö. = shpeshherë - shën i përkthyeses), Joh. Kant., Hist. 509, *Argyropolichne*: Laon. Chalk. 1.196, 2.27–29, Chron. Tocc. 3220.

Mesopotamon: Joh. Kant., Hist. 509, PRK I 2.35.

Rajoni *Muzakea*: Chron. Tocc. 1682.

Rajoni (dhe *phrurion* / Kështjella) *Skreparion*: Joh. Kant., Hist. 1.495.

Rajoni *Bagenetia*: Chron. Mor. 9162, Dem. Chomat., Ponemata 44.2, *Bagenitia*: Joh. Apokaukos, Not. Epist. 57.71, PRK I 2.33.

³¹ Sipas Shkurtit, *Der Mythos*, f. 130, Shkodra, Kruja, Lezha, Durrësi, Vlora dhe Gjyrokastri duhen emërtuar që në fillim të sundimit osman si qytete, ndërsa vendbanimet e mëposhtme, që më parë ishin fshatra ose nuk ekzistonin fare, u

Por, pavarësisht nga kjo, numri i përgjithshëm i banorëve (dhe denduria e popullsisë) në rajonin e Shqipërisë së Mesme dhe të Jugut ishte më i lartë, sepse qytetet porte me popullsi të dendur dhe zonat bregdetare i përkisnin atëhere, siç thamë, në pjesën më të madhe Venedikut. I vetmi port i madh që kontrollohej atëherë nga osmanët dhe që siguronte një lidhje me udhëtimin detar në Adriatik dhe Jon ishte ai i Vlorës (Aulon, Avlona, Valona); turqit e pushtuan prej vitit 1417 kështjellën e qytetit të vogël të Kaninës, që ndodhet afërsisht 4 km mbi Vlorë, prandaj Kanina edhe në Defter shënohet si kryeqendër e vilajetit me të njëjtin emër. Është e paqartë nëse edhe gjiri i Borshit, që ndodhet në juglindje të Himarës dhe është më pak i përshtatshëm si vend ankorimi, ishte atëhere nën kontrollin turk apo jo; kryeqendra osmane Sopot (kryeqendër e nahijetit me të njëjtin emër në Defter) nuk ndodhej direkt në bregdet, i cili midis Vlorës dhe Sarandës ka vetëm pak gjire portuale të përshtatshme për lundrimin detar.

Pra, në total, dendësia e popullsisë, edhe duke marrë parasysh territoret veneciane, mbeti ndoshta dukshëm nën 20 banorë / km²; ajo ishte pra shumë e pakët, çka vërtetohet në mënyrë indirekte edhe nga krahasimi me vlerat e shek. XX.³² Përpjekja për të vazhduar diferencimin rajonal brendapërbrenda sanxhakut nuk sjell ndonjë gjë të re. Klasifikimi sipas një ndarjeje hapësinore *veri / mes / jug* (tabela 3) sjell tre zona të ngjashme nga sipërfaqja, por nuk bën të duket asnjë dallim i rëndësishëm: veri 7.5–12.8 / mes 7.3–12.8 / jug 7.6–13.0 banorë / km².

Nëndarja në *territore në brendësi të vendit dhe në zona bregdetare* (tabela 4), që në fakt është e logjikshme dhe i përgjigjet gjerësisht një nëndarjeje në lindje e perëndim, nuk sjell dallime të rëndësishme, për shkak se ultësirat bregdetare ishin pjesërisht kënetë dhe sepse Defteri nuk mund të përfshinte (ende) vendbanime të rëndësishme në bregdet si pasojë e arsyeve politike të përmendura. Bie në sy që rrethi i vogël administrativ Kleisura, megjithë strukturën e saj sipërfaqësore malore dhe distancën e largët nga bregdeti, ishte relativisht e populluar dendur: kjo mund të shpjegohet ndoshta në radhë të parë me rëndësinë e saj –

zhvilluan për herë të parë si qytete atëherë (deri rreth 1600): Delvina, Kavaja, Elbasan, Gjakova, Peqin, Korça dhe Prishtina.

³² Në vitin 1923 Shqipëria kishte 803.948 banorë, pra një dendësi popullore prej 28/km², krh. Lienau - Prinzing, *Beiträge zur Geographie* (Artikuj për gjeografinë), f. 128, tabela 2.

pavarësisht nga vështirësitë natyrore të qarkullimit – si kryqëzim i rrugëve të rëndësishme për tregtinë në brendësi të vendit.

"Prova të kundërta" në bazë të renditjes sipas *dendësisë së popullsisë* (tabela 5) ose *të shtrirjes sipërfaqësore* (tabela 6) të rretheve administrative sjellin pak më shumë të dhëna, sepse bëhet e qartë se të tria zonat më të vogla nga sipërfaqja - Sopot, Tomorince dhe Klisura – duket sikur kanë njëkohësisht edhe dendësinë me të madhe të popullsisë. Për rrethin gjithashtu të vogël Muzakiye kjo nuk është e vërtetë. Një sqarim i mundshëm mund të jetë ky: të tre rrethet e para, duke qenë të vogla, janë regjistruar më lehtë dhe më shpejt administrativisht nga pushtetarët lokalë dhe nëpunësit e tyre se sa krahinat e mëdha; veç kësaj, Sopot dhe Klisura ndodheshin sa i përket trafikut në një pozitë relativisht të favorshme kundrejt kryeqytetit të Sanxhakut, Aryurikasri, dhe kishin secila nga një kështjellë me garnizon si qendër; së fundi, Sopot ishte në bregdet dhe kishte një port, ndërsa Klisura, siç thamë, ishte e rëndësishme për qarkullimin tregtar në brendësi të vendit. Përkundrazi, Myzakiye ndodhej larg qendrës, nuk kishte asnjë përfitim nga bregdeti përpara saj, sepse ky ishte ende nën kontrollin venecian dhe përbëhej në pjesën më të madhe nga ultësira moçalore.

Pra, përfundimisht del që *Defteri i Sanxhakut Arnaut* përfaqëson një burim mjaft të pasur për historinë e vendbanimeve dhe demografinë historike të krahinës së Epirit në Mesjetën e Vonë dhe Kohën e Re të hershme, nëse merr parasysh situatën specifike fizike-geografike të rajonit dhe kushtet në të cilat është hartuar ky defter, si dhe nëse merr në konsideratë përveç këtyre edhe veçoritë e përgjithshme të defterit të hershëm osman. Në këto kushte ai ofron jo vetëm një skelet bazë të mirë për një paraqitje të përgjithshme të zhvillimit të vendbanimeve dhe numrit të popullsisë, por më tej edhe - siç do të tregohet në një vend tjetër - një bazë të dobishme për hamendësime lidhur me rrjetin rrugor, hierarkinë e vendbanimeve dhe në përgjithësi për historinë ekonomike të rajonit në kapërcyellin prej Mesjetës në Kohën e re.

(Tabela 1) *Sancak-i Arvanid: sipërfaqet, fshatrat, ekonomitë familjare (shtëpitë), të ardhurat*³³

<i>Provinca</i>	$\approx km^2$	<i>Fshatra</i>	<i>Vh / Wi / Le</i>	ΣHh	<i>Të ardhura</i>
[I] ARYURIKASRI	3285	243	5092 / 317 / 373	5782	
Timar 1 Beği	---	36	951 / 59 / 103	1113	91333
Timare 2-58	---	132	2453 / 143/146	2742	189252 +
Lahtakasru	190	9	175 / 4 / 2	181	10588
Vayonetya	515	29	837 / 75 / 95	1007	84616
Himara	90	10	229 / 23 / 22	274	19192
Belgrad	50 ³⁴	5	111 / 3 / 4	118	13946
Muzakiye	400	22	336 / 10 / 1	347	52301
[II] SOPOT	160	27	541 / 10 / 12	563	
Timar 59 Subaşı	---	13	280 / 2 / 2	284	20013
Timare 60-66	---	14	261 / 8 / 10	279	15939 +
[III] KLISURA	270	55	1199 / 33 / 2	1233	
Timar 67 Subaşı	---	21	541 / 15 / --	556	33257
Timare 68-74	---	34	658 / 18 / 2	678	2430 ++
[IV] KANINA	1270	208	2328 / 183 / 2	2513	
Timar 75 Subaşı	---	10	397 / 43 / --	440	46208
Timare 76-144	---	198	1931 / 140 / 2	2073	194506 ++
[V] BELGRAD	1295	155	2623 / 110 / 49	2782	
Timar 145 Subaşı	---	11	617 / 44 / 32	693	50762
Timare 146-205	---	144	2006 / 66 / 17	2089	154374
[VI] Tomorince	260	33	749 / 25 / --	774	
Timare 206-215	---	33	749 / 25 / --	774	37985
[VII] ISKARAPAR	585	68	1160 / 51 / 1	1212	
Timar 216 Subaşı	---	23	404 / 22 / --	426	33644
Timare 217-239	---	45	756 / 29 / 1	786	48667 +

³³ \approx "afërsisht", Hh "ekonomi familjare" (e taksuar), Vh "ekonomi familjare e plotë", Wi "ekonomi familjare e një njeriu të ve", Le "ekonomi familjare e një të pamartuari", Σ "shuma", të ardhurat (*hâsil*) në *akçe* (për këtë shih shën. 22), + mungojnë disa të dhëna, ++ mungojnë mjaft të dhëna, +++ nuk ka asnjë të dhënë.

³⁴ Këto 50 km² iu zbritën shumës së sipërfaqeve të vilajetit të Beratit dhe iu shtuan atij të Gjirokastrës.

[VIII] PAVLO KURTIK	1100	175	2878 / 39 / --	2917	
Timar 240 Beğ	---	77	1082 / 18 / --	1100	86747 ++
Timare 241-260	---	98	1796 / 21 / --	1817	126544 ++
[IX] ÇARTALOS	1105	105	2644 / 41 / --	2685	
Timar 261 Subaşı	---	11	694 / 10 / --	704	41978
Timare 262-275	---	40	808 / 10 / --	818	101092
Mevkufât	---	54	1142 / 21 / --	1163	47848
[X] AKÇAHISAR	1370	216	2219 / 170 / --	2389	
Timar 276 Subaşı	---	27	369 / 21 / --	390	32668
Akçahisar nefis	---	--	125 / 19 / --	144	+++
Timare 277-335	---	189	1725 / 130 / --	1855	164086
Σ Sancak Arvanid	10700	1285	21433 / 979 / 439	22851	1699976 ++

(Tabela 2) *Sancak-i Arvanid: sipërfaqet, fshatrat, ekonomitë familjare (shtëpitë), banorët, dendësia e popullsisë (3.5-6 banorë/ ekonomi familjare)*³⁵

<i>Provinca</i>	<i>≈ km²</i>	<i>Fshatra</i>	<i>ΣHh</i>	<i>≈ banorë</i>	<i>≈ banorë/km²</i>
Aryurikasrı	3285	243	5782	20237–34692	6.1–10.6
Lahtakasrı	190	9	181	633–1086	3.3–5.7
Vayonetya	515	29	1007	3524–6042	6.8–11.7
Himara	90	10	274	959–1644	10.6–18.3
Belgrad	50	5	118	413–708	8.2–14.2
Muzakiye	400	22	347	1214–2082	3.0–5.2
SOPOT	160	27	563	1970–3378	12.3–21.1
KLISURA	270	55	1233	4315–7398	15.9–27.4
KANINA	1270	208	2513	8795–15078	6.9–11.9
BELGRAD	1295	155	2782	9739–16692	7.5–12.9
Tomorince	260	33	774	2709–4644	10.4–17.9
ISKARAPAR	585	68	1212	4242–7272	7.2–12.4
PAVLO KURTIK	1100	175	2917	10209–17502	9.2–15.9
ÇARTALOS	1105	105	2685	9397–16110	8.5–14.6
AKÇAHISAR	1370	216	2389	8361–14334	6.1–10.5
Σ Sancak Arvanid	10700	1285	22851	79978–137106	7.4–12.8

³⁵ ≈ afërsisht, Hh “ekonomi familjare” (e taksuar), Σ “shuma”, (të taksuar) banor (3,5–6 / për ekonomi familjare). – Për *banorët* presupozohet një vlerë minimale prej 3,5 dhe një vlerë maksimale prej 6 persona për çdo ekonomi familjare, krh. për këtë bibliografinë që përmendet në shën. 28.

(Tabela 3) *Sancak-i Arvanid, Veri / Mes / Jug*
Sipërfaqet, fshatrat, shtëpitë, numri i banorëve, dendësia e popullsisë (3.5–6
banorë/ ekonomi familjare)³⁶

<i>Provinca</i>	<i>≈ km²</i>	<i>Fshatra</i>	<i>ΣHh</i>	<i>≈ banorë</i>	<i>≈ banorë/ km²</i>
Σ Sancak Arvanid	10700	1285	22851	79978–137106	7.4–12.8
[X] AKÇAHISAR	1370	216	2389	8361–14334	6.1–10.4
[VIII] PAVLO KURTIK	1100	175	2917	10209–17502	9.2–15.9
Σ Veri	2470	391	5306	18571–31836	7.5–12.8
[IX] ÇARTALOS	1105	105	2685	9397–16110	8.5–14.5
[I] Muzakiye	400	22	347	1214–2082	3.0–5.2
[V] BELGRAD ³⁷	1345	160	2900	10150–17400	7.5–12.9
[VI] Tomorince	260	33	774	2709–4644	10.4–17.8
[VII] ISKARAPAR	585	68	1212	4242–7272	7.2–12.4
[IV] KANINA	1270	208	2513	8795–15078	6.9–11.8
Σ Mes	4965	596	10431	36508–63586	7.3–12.8
[III] KLISURA	270	55	1233	4315–7398	15.9–27.4
[II] SOPOT	160	27	563	1970–3378	12.3–21.1
[I] Aryurikasri ³⁸	2835	216	5317	18609–31902	6.5–11.2
Σ Jug	3265	298	7113	24895–42678	7.6–13.0

³⁶ ≈ “afërsisht”, (e taksuar) Hh “ekonomi familjare”, Σ “shuma”, (të taksuar) banorë (3,5–6 / ekonomi familjare). – Për *banorët* presupozohet një vlerë minimale prej 3,5 dhe një vlerë maksimale prej 6 persona për çdo ekonomi familjare, krh. për këtë bibliografinë që përmendet në shën. 28.

³⁷ me Beratin, Myzeqe.

³⁸ me Lahtakasru, Vajonetia, Himara, pa Beratin, Myzeqe.

(Tabela 4) *Sancak-i Arvanid, Brendësia e vendit / Bregdeti*
Sipërfaqet, fshatrat, shtëpitë, numri i banorëve, dendësia e popullsisë (3.5–6
banorë/ ekonomi familjare)³⁹

<i>Provinca</i>	<i>≈ km² Fshatra</i>	<i>ΣHh</i>	<i>≈ banorë</i>	<i>≈ banorë/ km²</i>	
Σ Sancak Arvanid	10700	1285	22851	79978–137106	7.4–12.8
[IX] ÇARTALOS	1105	105	2685	9397–16110	8.5–14.5
[V] BELGRAD ⁴⁰	1345	160	2900	10150–17400	7.5–12.9
[VI] Tomorince	260	33	774	2709–4644	10.4–17.8
[VII] ISKARAPAR	585	68	1212	4242–7272	7.2–12.4
[III] KLISURA	270	55	1233	4315–7398	15.9–27.4
BRENDËSIA E VENDIT 3565	421	8804	30813–52824	8.6–14.8	
(IDEM PA KLISURA	3295	366	7571	26498–45426	8.0–13.8)
[X] AKÇAHISAR	1370	216	2389	8361–14334	6.1–10.4
[VIII] PAVLO KURTIK	1100	175	2917	10209–17502	9.2–15.9
[I] Muzakiye	400	22	347	1214–2082	3.0–5.2
[IV] KANINA	1270	208	2513	8795–15078	6.9–11.8
[II] SOPOT	160	27	563	1970–3378	12.3–21.1
[I] Aryurikasrı ⁴¹	2835	216	5317	18609–31902	6.5–11.2
Bregdeti	7135	864	14046	49158–84276	6.9–11.8

³⁹ ≈ “afërsisht”, (e taksuar) Hh “ekonomi familjare”, Σ “shuma”, (të taksuar) banorë (3,5–6 / ekonomi familjare). – Për *banorët* presupozohet një vlerë minimale prej 3,5 dhe një vlerë maksimale prej 6 persona për çdo ekonomi familjare, krh. për këtë bibliografinë që përmendet në shën. 28.

⁴⁰ me Belgrad, Muzakiye.

⁴¹ me Lahtakasru, Vayonetya, Himara, pa Belgrad, Muzakiye.

(Tabela 5) *Sancak-i Arvanid, Rajonet sipas dëndësisë
Sipërfaqet, fshatrat, shtëpitë, numri i banorëve, dëndësia e popullsisë (3.5–6
banorë/ ekonomi familjare)⁴²*

<i>Provincat</i>	$\approx km^2$	<i>Fshatra</i>	ΣHh	$\approx banorë$	$\approx banorë/km^2$
Σ Sancak Arvanid	10700	1285	22851	79978–137106	7.4–12.8
[I] Muzakiye (M) 400	22	347		1214–2082	3.0–5.2
[X] AKÇAHISAR (N)	1370	216	2389	8361–14334	6.1–10.4
[I] Aryurikasri ⁴³ (S)	2835	216	5317	18609–31902	6.5–11.2
[IV] KANINA (M)	1270	208	2513	8795–15078	6.9–11.8
[VII] ISKARAPAR (M)	585	68	1212	4242–7272	7.2–12.4
[V] BELGRAD ⁴⁴ (M)	1345	160	2900	10150–17400	7.5–12.9
[IX] ÇARTALOS (M)	1105	105	2685	9397–16110	8.5–14.5
[VIII] PAVLO KURTIK (N)1100	175	2917	10209–17502	9.2–15.9	
[VI] Tomorince (M)	260	33	774	2709–4644	10.4–17.8
[II] SOPOT (S)	160	27	563	1970–3378	12.3–21.1
[III] KLISURA (S)	270	55	1233	4315–7398	15.9–27.4

(Tabela 6) *Sancak-i Arvanid, Rajonet sipas madhësisë
Sipërfaqet, Fshatrat, ekonomitë familjare, numri i banorëve, dëndësia e
popullsisë (3.5–6 banorë/ ekonomi familjare)⁴⁵*

<i>Provincia</i>	$\approx km^2$	<i>Fshatra</i>	ΣHh	$\approx banorë$	$\approx banorë/km^2$
Σ Sancak Arvanid	10700	1285	22851	79978–137106	7.4–12.8
[II] SOPOT (S)	160	27	563	1970–3378	12.3–21.1
[VI] Tomorince (M)	260	33	774	2709–4644	10.4–17.8
[III] KLISURA (S)	270	55	1233	4315–7398	15.9–27.4

⁴² \approx “afërsisht”, (e taksuar) Hh “ekonomi familjare”, Σ “shuma”, (të taksuar) banorë (3,5–6 / ekonomi familjare). – Për *banorët* presupozohet një vlerë minimale prej 3,5 dhe një vlerë maksimale prej 6 persona për çdo ekonomi familjare, krh. për këtë bibliografinë që përmendet në shën. 28.

⁴³ me Lahtakasru, Vayonetya, Himara, pa Belgrad, Muzakiye.

⁴⁴ me Belgrad, Muzakiye.

⁴⁵ \approx “afërsisht”, (e taksuar) Hh “ekonomi familjare”, Σ “shuma”, (të taksuar) banorë (3,5–6 / ekonomi familjare). – Për *banorët* presupozohet një vlerë minimale prej 3,5 dhe një vlerë maksimale prej 6 persona për çdo ekonomi familjare, krh. për këtë bibliografinë që përmendet në shën. 28.

[I] Muzakiye (M) 400	22	347		1214–2082	3.0–5.2
[VII] ISKARAPAR (M)	585	68	1212	4242–7272	7.2–12.4
[VIII] PAVLO KURTIK (N)1100	175	2917	10209–17502		9.2–15.9
[IX] ÇARTALOS (M)	1105	105	2685	9397–16110	8.5–14.5
[IV] KANINA (M)	1270	208	2513	8795–15078	6.9–11.8
[V] BELGRAD* (M)	1345	160	2900	10150–17400	7.5–12.9
[X] AKÇAHISAR (N)	1370	216	2389	8361–14334	6.1–10.4
[I] Aryurikasri** (S)	2835	216	5317	18609–31902	6.5–11.2

Përktheu nga origjinali gjermanisht:
Dr. Ina Arapi

* me Belgrad, Muzakiye.

** Me Lahtakasru, Vayonetya, Himara, pa Belgrad, Muzakiye.



Karte 1



S u m m a r y

DEFTER-I SANCAK-I ARVANID (THE LAND REGISTER OF SANDJAK OF ARVANID)
AS A SOURCE OF DEMOGRAPHIC DATA ON EPIRUS DURING THE TRANSITORY
PERIOD FROM THE BYZANTINE TO THE OTTOMAN OCCUPATION WITH TWO
MAPS AND SIX TABLES

The land register of Sandjak of Arvanid is the most ancient register that gives us important data on the administrative division, economic aspect and toponymy of a surface of more than 10.000 km² in the first half of the 15th century. Since the preparation for publication of this register in 1954 this source has been a main work used by many scholars of late Byzantine period and of the settlement of the Ottoman occupation in these regions. In this respect, the article in question has the target to offer a new approach on the conclusions a scholar can draw from this register striving to present a reflection of the demographic aspect of Sandjak of Arvanid for the period when the registration has taken place. In order to draw this demographic data the author is based mainly on the number of the houses registered in the register together with the economic data that are to be seen in this important source for the history of the area included in the Sandjak of Arvanid.